



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 18.11.2024, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-1468/24, për zyrtarin z. Burim Leci, Zëvendës Drejtor Ekzekutiv - Operativë i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

## A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin z. Burim Leci, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë - raportuesi i rastit (DPKI-1468/24), me të cilën është kërkuar inicimi i procedurës për vlerësimin e konfliktit të interesit për shkak se, siç pretendohet në raportimin e rastit, z. Burim Leci është përzgjedhur Zëvendës Drejtor Ekzekutiv - Operativë i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në vijim: AKP), ndërsa i njëjti është (ka qenë) drejtor menaxhues i subjektit "IP-KOS" SH.P.K., i cili subjekt ka në shfrytëzim një numër të madh të pompave të cilat i ka në menaxhim AKP-ja.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet e raportuesit të rastit sipas dispozitave të LPKI-së, konkretisht pretendimet që lidhen me dyshimin për konflikt të interesit për zyrtarin z. Burim Leci, me rastin e përzgjedhjes apo pranimit të tij në pozitën Zëvendës Drejtor Ekzekutiv - Operativë i AKP-së, duke qenë se i njëjti ka mbajtur dhe ushtruar pozitën drejtor

menaxhues i subjektit "IP-KOS" SH.P.K., si dhe ka trajtuar këtë çështje në kontekst të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, për shkak të këtyre dy pozitive.

Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-06-1608/23, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas z. Burim Leci është njoftuar lidhur me faktet për rastin e tij. Zyrtari i lartë në fjalë përmes korrespondencave me shkrim, ka paraqitur qëndrimet dhe argumentet e tij karshi pretendimeve të ngritura. I njëjti, ndër të tjera ka theksuar se, citojmë nga deklarata e tij:

*"[...] Që nga data 30.06.2024, nuk kam qenë më në pozitën e drejtorit menaxhues të IP-KOS sh.p.k., apo në ndonjë pozitë tjetër në këtë kompani. [...] Më datë 01.07.2024, kam njoftuar me shkrim Burimet Njerëzore të AKP-së se pranoj pozitën e ofruar të Zv. DEO dhe se më datë 15.07.2024 mund të filloj angazhimin profesional, kur dhe kam filluar në AKP. [...] Në dokumentet e nënshkrimit të kontratës me AKP-në, kam deklaruar me shkrim konfliktin e mundshëm të interesit me kompaninë IP-KOS sh.p.k. dhe largimin tim nga çdo vendimmarrje që lidhet me këtë kompani. [...] Nga fillimi i punës dhe deri më tani, nuk kam marrë pjesë në asnjë rast të vendimmarrjes që ka të bëjë me kompaninë ku kam punuar më parë. [...]"* Lidhur me deklaratimet e tij, z. Burim Leci ka dërguar në Agjenci edhe dokumentet/dëshmitë përkatëse.

Përveç kësaj, më qëllim të sqarimit të situatës gjithnjë në kontest të zbatimit të dispozitave të LPKI-së dhe konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, Agjencia ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) informatat dhe historikun e biznesit "IP-KOS" SH.P.K.. ARBK duke vepruar sipas kërkesës si më lartë, ka dërguar në Agjenci informatat dhe historikun e biznesit në fjalë.

Kësisoj, Agjencia pasi ka administruar si prova (vetëm provat që lidhen me vërtetimin e fakteve - pretendimeve për konflikt të interesit) kërkesën e raportuesit të rastit dhe dokumentacionin e bashkangjitur, deklaratën sqaruese të z. Burim Leci dhe dokumentacionin/dëshmitë e dërguara në Agjenci, si dhe informatat dhe historikun e biznesit "IP-KOS" SH.P.K. të pranuar nga ARBK, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga Marrëveshja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e lidhur më datë 20.06.2024, ndërmjet z. Burim Leci dhe subjektit "IP-KOS" SH.P.K., rezulton se z. Burim Leci ka shkëputur (përmbyllur) marrëdhënien e punës me "IP-KOS" SH.P.K., ashtu që nga data 30.06.2024, kanë pushuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga kjo marrëdhënie e punës.

Sipas historikut të biznesit të subjektit "IP-KOS" SH.P.K., rezulton se z. Burim Leci ka qenë Drejtor Menaxhues i biznesit në fjalë nga data 30.07.2019 deri më datë 24.07.2024.

Sipas Akt emërimit të datës 15.07.2024, të lëshuar nga AKP, z. Burim Leci është emëruar Zëvendës Drejtor Ekzekutiv - Operativë në AKP me kohëzgjatje prej datës 15.07.2024 deri më datë 14.07.2028.

Rrjedhimisht, z. Burim Leci me rastin e përzgjedhjes në pozitën e lartpërmendur në AKP, ka përfunduar marrëdhënien e punës me subjektin "IP-KOS" SH.P.K., ndërsa pas nënshkrimit të akt emërimit edhe zyrtarisht janë bërë ndryshimet në regjistrin e bizneseve në ARBK, ashtu që i njëjti nuk figuron të jet më Drejtor Menaxhues i biznesit në fjalë.



Referuar dokumentit zyrtar të AKP-së “Shpalosja e Interesit”, i nënshkruar nga z. Burim Leci më datë 16.07.2024, në pjesën e tretë zyrtari i lartë në fjalë, ndër të tjera, ka deklaruar se: “[...] kur të diskutohet apo të vendoset në lidhje me qiratë e kompanisë “IP-KOS” SH.P.K., duhet të shpaloset konflikti i mundshëm i interesit”.

Në kuptim të gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia konstatoi si në pikën I. të dispozitivit të këtij Vendimi, sepse *së pari* vet fakti se z. Burim Leci është përzgjedhur apo pranuar në pozitën Zëvendës Drejtor Ekzekutiv - Operativë i AKP-së, duke qenë se i njëjti ka mbajtur dhe ushtruar pozitën drejtor menaxhues i subjektit “IP-KOS” SH.P.K., apriori nuk bie ndesh dhe nuk ndalohet me dispozitat e LPKI-së.

*Së dyti*, Agjencia ka trajtuar këtë rast në kontekst të papajtueshmërisë së mbajtjes apo ushtrimit të dy pozitave nga z. Burim Leci (Zëvendës Drejtor Ekzekutiv - Operativë i AKP-së dhe drejtor menaxhues i subjektit “IP-KOS” SH.P.K.), ashtu që ka gjetur dhe konstatuar se z. Burim Leci me rastin e marrjes së pozitës së tij zyrtare në AKP (madje edhe para nënshkrimit të akt emërimit), ka shmangur gjendjen e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.*

Ndërsa me nenin 8 [Detyrimi për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *“1. Me marrjen e detyrës dhe gjatë ushtrimit të saj, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit ndërmjet interesave të tij publike dhe private.”* Ndërsa me paragrafin 6 të këtij neni është përcaktuar se: *“6. Zyrtari apo institucioni i ndërmarrin veprimet e parapara në paragrafët 1. deri në 5. të këtij neni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh.”*

Përveç kësaj, me dispozitat e nenit 19 të LPKI-së janë paraparë masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave, ashtu që me paragrafin 1, nënparagrafi 1.3. të këtij neni është përcaktuar se: *“1. Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave: [...] 1.3. jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik [...]”.*

Në rastin konkret, siç u tha më lartë, z. Burim Leci me rastin e marrjes së pozitës së tij zyrtare në AKP (madje edhe para nënshkrimit të akt emërimit), ka ndërmarr masat sipas dispozitave të sipërcituara duke shmangur situatën e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, dhe atë fillimisht me anë të nënshkrimit të marrëveshjes për shkëputjen e marrëdhënies së punës me subjektin “IP-KOS” SH.P.K., si dhe me regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e bizneseve në ARBK, ku i njëjti nuk figuron të jetë drejtor menaxhues i këtij biznesi.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Yll Buleshkaj  
Drejtör i Agjencisë për  
Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit z. Burim Leci;
- Raportuesit të rastit;
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

